




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - Competition Authority of the Republic of Kosovo



Nr. 24/2023

Prishtinë, më 24.02.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenet 10, 28, 29, 34, 35 paragrafi (5) dhe nenin 54, paragrafi (2.3) të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe nenin 6 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas kërkesës së ndërmarrjes “Medical Group Sh.p.k” nga Prishtina kundër kompanisë “NTP Medica Sh.p.k” nga Prishtina, lidhur me pretendimin për keqpërdorim të Pozitës Dominuese, në mbledhjen e mbajtur me datën 24.02.2023, merr këtë:

KONKLUZION

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant Autoriteti i Konkurrencës konstaton se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore sipas nenit 35 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndaj ndërmarrjes NTP Medica Sh.p.k, lidhur me Kontratën Publike Kornizë, Ref. Nr. 00220-22-91-1-1-5/C236 për furnizimin Emergjent me Oxygen për nevojat e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, sa i përket çmimit të ofertuar nën çmimin e kostos.

Arsyetim

Autoriteti më datën 28.04.2022, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot.131/22-01/H nga paraqitësi i iniciativës ndërmarrja Medical Group Sh.p.k kundër N.T.P Medica Sh.p.k me pretendimin se: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), në cilësi të Autoritetit kontraktues, ka hapur aktivitetin e prokurimit me titullin “Furnizim Emergjent me Oxygen për nevojat e SHSKUK-së” me numër të prokurimit 00220-22-91-1-1-5 dhe numër të brendshëm 220-22-005-115.

Për këtë aktivitet të prokurimit, përmes letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm, të datës 01.02.2022, SHSKUK ka njoftuar se kompania NPT Medica Sh.p.k. shpallet e suksesshme dhe rrjedhimisht, do të shpërblehet me kontratë. Kjo me arsyetimin se oferta e të njëjtit ka qenë oferta me çmimin më të ulët, përkatësisht për shkak se NPT Medica Sh.p.k. ka ofertuar me çmim të njësisë prej EUR 1.19 për kg.

Në këtë drejtim, duhet të kemi parasysh faktet vijuese:

- Në tenderin e parë, më datën 22.12.2021, me numër të referencës 00220-21-6529-1-1-1, OE Medica Sh.p.k. ka ofertuar me çmim prej EUR 1.91 (*një euro e nëntëdhjetë e një cent*), dhe vetëm se ka humbur tenderin me çmim, ka dërguar ankesën në OSHP.
- Pasi lënda ka kaluar për shqyrtim në OSHP, është hapur procedura për negociata, ku OE në fjalë e ka zbritur çmimin në EUR 1 (*një euro*). OE Medica Sh.p.k ka ofertuar për vite të tëra në aktivitetet e prokurimit për furnizimin me oksigjen, ku ka ofruar produkte me çmim të njësisë në vlerë prej EUR 2.02 (*dy euro e dy cent*).

Pra, në vitet e kaluara, OE Medica Sh.p.k ka ofertuar me çmim pothuajse dyfish më të lartë se sa në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka deklaruar se shuma e caktuar për njësi produkti përbën vlerën reale të tregut për ato produkte, me ç'rast edhe është shpërblyer me Kontratë.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se ndryshimi i çmimit nga ana e OE Medica Sh.p.k në nivelin në të cilin është bërë, është jo vetëm i dyshimtë, por në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Prandaj, konsiderojmë se:

- A. NPT Medica Sh.p.k. ose ka abuzuar në tenderët paraprak, duke ofertuar me çmim më të lartë se sa vlera reale, ose
- B. Aktualisht është duke e keqpërdorur pozitën e saj dominuese në treg duke ofertuar kështu me çmim abnormalisht të ulët.

Në këtë drejtim, Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës ("LMK"), në Nenin 10 të tij, ofron disa përkufizime lidhur me pozitën dominuese të një ndërmarrje, ku ndër të tjera, përcakton se pozitë dominuese ka një ndërmarrje si furnizues ose blerës i disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve, e cila ka fuqi të rëndësishme në treg në krahasim me konkurrentët ekzistues ose potencialë.

Fakti se NPT Medica Sh.p.k. është shpërblyer me Kontratë për disa vite me radhë për produktet e njëjta, reflekton faktin se ky operator gëzon pozitë dominuese në treg.

Produkti është Oksigjeni mjekësor. Siç dihet, i njëjti është produkt kyç për funksionim normal të shumicës së shërbimeve dhe veprimeve që kryhen në një spital, e sidomos kur bëhet fjalë për një institucion shëndetësor publik. Meqenëse ky produkt nuk prodhohet në Kosovë, i njëjti është vetëm subjekt i importit nga vendet/shtetet e tjera.

Produkti Oksigjen mjekësor është importuar nga vendet/shtetet e tjera dhe është shitur në Kosovë. Përkatesisht, produkti në fjalë ka qenë objekt i aktiviteteve të ndryshme të prokurimit, ku Autoritet Kontraktues ka qenë SHSKUK - subjekt juridik publik, e me të cilin ka ofertuar NPT Medica SH.P.K.

Fillimisht duhet të kemi parasysh faktin se ndryshimi i lartësisë së çmimit për njësi, për dallim nga çmimet për produktet e njëjta që janë ofruar më herët nga OE Medica Sh.p.k. bien në kuadër të formave të abuzimit (keqpërdorimit) të pozitës dominuese të ndërmarrjes, të përcaktuara më lartë. Për më tepër, duke qenë se çmimi i ofruar nga OE Medica Sh.p.k. është i ulët përtej normales, kurse çmimi i tregut për produktet e tilla, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë botën, është minimalisht 1.56 deri në 1.60 Euro, lë dyshime për kualitetin e produkteve që janë ofruar nga OE Medica Sh.p.k.

Në këtë drejtim, duhet të kemi parasysh se me krijimin dhe fuqizimin e pozitës dominuese dhe monopoliste të NPT Medica Sh.p.k. është eliminuar konkurrenca ndërmjet kompanive dhe rrjedhimisht, është shkelur ligji në fuqi. Si pasojë, është dëmtuar buxheti i kompanisë Medical Group, i kompanive të tjera, e sidomos buxheti i shtetit.

Në anën tjetër, mos-ekzistenca e pozitës dominuese në treg, është e rëndësisë tejte të madhe. Një mjedis konkurrues siguron se ekziston një garë për prodhimin, apo në rastin konkret, furnizimin me produkte sa më të mira. Konkurrenca e fuqishme, ndërkaq, përbën nxitësin kryesor të rritjes së produktivitetit. Në këtë mënyrë, ofrohet një mundësi për zgjedhjen e produkteve më të mira, e çmimeve konkurruese, si dhe parandalohet shkatërrimi i tregut të lirë.

Medical Group ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë SHSKUK-së, përmes të cilës ka kërkuar që të anulohet Vendimi i SHSKUK-së për shpalljen si të suksesshme të NPT Medica Sh.p.k. dhe ka kërkuar nga SHSKUK që të iniciojë procedurë hetimore pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me keqpërdorimet/abuzimet e mundshme të kryera nga NPT Medica Sh.p.k.

Po ashtu, më datë 15.03.2022, Medical Group i është drejtuar edhe ATK-së, me ç'rast ka kërkuar sqarime lidhur me aplikimin e normës së TVSH-së në raste të importeve dhe shitjeve dhe ka kërkuar që të fillojë hetime ndaj Doganës së Kosovës.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit

Autoriteti kontraktues SHSKUK me datën 15.09.2021 kishte bërë iniciimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Oxygen Medicinal nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së", me nr. të prokurimit: 220-21-6529-1-1-1, e cila kishte zbatuar procedurë të hapur të prokurimit. Lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuare e kontratës: 2,146,200.00€ (*dy milion e njëqind e katër dhjetë e gjashtë mijë e dyqind euro*), me datën 22.12.2021, AK kishte bërë hapjen e ofertave, ndërsa me datën 11.01.2022 kishte marrë vendim për dhënien e kontratës ndërmarrjes Medical Group Sh.p.k

Me datën 27.01.2022, ndërmarrja NPT Medica Sh.p.k, kishte parashtruar ankesë në SHSKUK kundër njoftimit për dhënien e kontratës, me të cilin ishte rekomanduar për kontratë ndërmarrjen Medical Group Sh.p.k, gjithashtu me datën 07.02.2022, kishte parashtruar ankesë pranë OSHP. Eksperti shqyrtues i OSHP kishte propozuar panelit shqyrtues që ankesa e ndërmarrjes NPT Medica Sh.p.k, të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të refuzohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Pasi lënda është kthyer në rivendosje AK kishte lidhur Kontratë Publike Kornizë 12 Muaj/C236, ref nr. 00220-22-91-1-1-5/C236 dhe nr. i brendshëm: 220-22-005-115, e lidhur me datën 09.02.2022 me ndërmarrjen N.T.P Medica Sh.p.k. kontrata ishte nënshkrua për njësi për kg me çmim pa TVSH prej 1.01€.

Tregu relevant

Tregu gjeografik - Furnizimi me Oxygen për nevojat e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është bërë në njësitë organizative të SHSKUK-së në Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Spitali i Përgjithshëm Prizren, Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, Spitali i Përgjithshëm

Pejë, Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë, Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, Spitali i Përgjithshëm Gjilan, Spitali i Përgjithshëm Vushtrri andaj:

Duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit - "Oxygen Medicinal nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së", produkt kyç për funksionimin normal të shumicës së shërbimeve dhe veprimeve që kryhen në një spital.

Analiza e Konkurrencës

Lidhur me rastin, Autoriteti bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenin 6 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka analizuar Pozitën Dominuese të ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, e cila në vitin 2020 kishte **15.216 %** të tregut relevant, në vitin 2021, **20.820 %** ndërsa deri më 31.10.2022, **24.07%**. Sipas të dhënave të ofruara nga Dogana e Kosovës dhe ndërmarrja N.T.P Medica Sh.p.k, e njëjta nuk kishte pozitë dominuese.

Autoriteti analizoj pozitën e ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, edhe pse nuk kishte pozitë dominuese në vitet e potencuar më sipër, bazuar në nenin 6 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në të cilin potencohet se: Barra e konstatimit që pozitën dominuese në treg mund ta ketë edhe pjesëmarrësi, pjesa e të cilit në tregun relevant është më e ulët se njëzet e pesë për qind (25%), respektivisht në raste të dominimit kolektiv më e ulët se dyzet për qind (40%), bie mbi Autoritetin.

Autoriteti ka analizuar çmimin importues pa TVSH me përshkrimin doganor: Oksigjen Medicinal (*Gaz medicinal*) O2-Lëngët në Bombola, në vitin 2020, ishte 1.10 Euro për kg. Në vitin 2021, 1.10, Euro, ndërsa deri më datën 30.10.2022, ndërmarrja nuk kishte importuar Oksigjen të Gaztë në Bombola, por e njëjta kishte importuar lëndën e parë për prodhime me përshkrim doganor: Oksigjen medicinal (*Gaz medicinal*) O2 - Lëngët 100% CAS Nr.7782-44-7, NRS: S201184100-1; e cila ishte importuar me çmim prej 0.13 cent për kg.

Autoriteti analizojë çmimin ndër çmimin e kostos, gjatë analizimit të dokumentacionit të ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, dhe se nuk gjeti se e njëjta kishte vendosur çmimin nën kosto, nga të dhënat Doganore për Produktin Oksigjen Medicinal (*Gaz medicinal*) O2 - Lëngët 100% CAS Nr.7782-44-7, NRS: S201184100-1; deri më datën 31.10.2022, ndërmarrja kishte importuar çmimin kushtues prej 0.13 cent për kg, gjithashtu sipas të dhënave të ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, produkti i importuar ishte lëndë e parë, i cili përpunohet në fabrikë e më pastaj shitet si produkt i gatshëm, për këtë produkt ndërmarrja kishte lidhur Kontratën Publike Kornizë me SHSKUK për 12 Muaj/C236, ref nr. 00220-22-91-1-1-5/C236 dhe nr. i brendshëm: 220-22-005-115, e lidhur me datën 09.02.2022 me çmim 1,01 (*një euro e zero një cent*), pa TVSH, për kg.

Autoriteti nuk analizoi çmimet e tepruara, për faktin se në Formularin e tenderit të datës 22.12.2021, me numër të prokurimit 00220-21-6529-1-1-1, ndërmarrja N.T.P Medica Sh.p.k, kishte ofertuar me çmim 1,75 (*një euro e shtatëdhjetë e pese cent*), me këtë çmimi ndërmarrja nuk kishte fituar tenderin. Ndërmarrja N.T.P Medica Sh.p.k, nuk kishte lidhur kontratë me SHSKUK me çmimin 1,75 (*një euro e shtatëdhjetë e pese cent*), por e njëjta kishte lidhur Kontratë Publike

Kornizë 12 Muaj/C236, Ref. Nr. 00220-22-91-1-1-5/C236 dhe nr. i brendshëm: 220-22-005-115, e lidhur me datën 09.02.2022, me çmimin 1,01 (një euro e zero një cent), pa TVSH, për këtë arsye nuk janë analizuar çmimet e tepruara.

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak, konsideron se ndërmarrja N.T.P Medica Sh.p.k, në kontratën e negociuar për shitjen e produktit Oksigjen mjekësor, nuk kishte zbatuar kushte të ndryshme për blerësit, për t'i vendosur në pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën, për faktin se e njëjta nuk kishte shitur produktin ndërmarrjeve konkurruese, por kishte negociuar me një organ shtetëror në rastin konkret me SHSKUK-në sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Autoriteti konsideron se çmimi i negociuar i ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, me SHSKUK-në ishin transparente, për faktin se e njëjta kishte negociuar me një organ shtetëror mbi bazën e Ligjit të Prokurimit Publik, me këtë rast SHSKUK kishte pasur mundësi zgjedhje te kompanitë tjera të cilat importojnë dhe shesin produktin Oksigjen Mjekësor, por oferta e ndërmarrjes N.T.P Medica Sh.p.k, ishte konsideruar ekonomikisht më e favorshme.

Për nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Komisioni


Neime Binaku - Isufi
Kryetare


Kaltrina Sela
Nënkryetare




Nafije Osdautaj
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i iniciativës
- Arkiva
- Publikohet në web faqen e AKRK-së